

EURO – NAŠ NOVAC



nga 1. janari 2023.

EURO
HR
O

ZAMJENA
HRVATSKE
KUNE
EUROM



www.euro.hr | 0800 20 23



Te nderuar bashkëqytetarë,
të dashur kroate e kroatë!

Më 1 janar 2023, Kroacia do ta zëvendësojë kunën me Euron, e cila do të bëhet monedha jonë e re. Me anëtarësimin në Bashkimin Evropian, edhe Kroacia ka vendosur të bëhet anëtare e

eurozonës dhe pas nëntë vite e gjysmë anëtarësim në Union, është gati për këtë hap të rëndësishëm.

Në maj 2018, Qeveria miratoi Strategjinë për vendosjen e monedhës Euro. Falë përmbushjes së të gjitha detyrimeve të marra pavarësisht pandemisë, kemi hyrë tashmë në bashkimin bankar dhe në mekanizmin evropian të kursit të këmbimit II, me hapin e fundit në korrik 2020, para vendosjes së monedhës Euro. Parakusht për këtë ishte stabiliteti politik, menaxhimi i përgjegjshëm i financave publike dhe zbatimi i reformave nga ne.

Kroacia do të bëhet anëtarja e 20-të e eurozonës. Krahës anëtarësimit në zonën Shengen, adoptimi i monedhës Euro do të plotësojë objektivat strategjike të kësaj qeverie, me synim integrimin më të thellë në Bashkimin Evropian. Për t'u mësuar më lehtë me monedhën Euro, nga 5 shtatori i këtij viti deri më 31 dhjetor 2023, të gjitha çmimet janë të shprehura në HRK dhe EUR. Qëllimi i kësaj broshure është të sigurojë të gjithë informacionin e nevojshëm dhe t'jua bëjë më të lehtë përshtatjen me monedhën e re.

Megenëse Euro është monedha e dytë më e fortë në botë, ekonomia dhe qytetarët tanë do të mbrohen më mirë nga krizat e ardhshme.

Shkëmbimi i kunës me Euron nuk do të shkaktojë kosto shtesë për qytetarët, sepse do të bëhet me një kurs të fiksuar në 7,53450 kuna për një Euro. Prandaj, frika nga rritja e çmimeve për shkak të konvertimit është e pabazë. Në të njëjtën kohë, po kujdesemi për mbrojtjen e konsumatorit për të parandaluar rritjen e pajustificuar të çmimeve. Qëllimi afatgjatë i kalimit në monedhën Euro është forcimi i konkurrencës dhe qëndrueshmërisë së ekonomisë kroate dhe rritja e standardit të jetesës së qytetarëve kroatë.

Kunën do ta ruajmë si simbol të traditës monetare kroate, ndërkohë që monedhat e tjera Euro do të zbkurohen me motivet tona kombëtare: harta e Kroacisë dhe vargu i Gunduliqit "O e bukur, o e dashur, o e ëmbla liri", figura e Nikola Teslës dhe simboli ndërkombëtar për Kroacinë (HR) në glagolitik, dhe të gjitha këto monedha do të kenë si motiv të përbashkët kroat fushën e shahut.

Vendosja e Euros është një hap i rëndësishëm në zhvillimin tonë ekonomik. Le ta shfrytëzojmë këtë mundësi brezash për të ndërtuar së bashku një Kroaci edhe më të suksesshme!

Andrej Plenković

Kryeministër i Qeverisë

Zagreb, tetor 2022.

SHKËMBIMI FALAS KUNA PËR EURO

Më 1 janar 2023, të gjitha kunat në llogari do të këmbehen automatikisht me Euro duke përdorur një kurs fiks konvertimi, pa asnjë pagesë.

Bankat, Agjencia Financiare (Fina) dhe Posta Kroate do të shkëmbejnë para në kuna për para në Euro për të gjithë konsumatorët brenda 12 muajve nga vendosja e Euros, pra nga 1 janari 2023 deri më 31 dhjetor 2023, me një kurs këmbimi fiks. Gjatë kësaj periudhe, shkëmbimi kryhet pa pagesë dhe në një transaksion mund të shkëmbehen maksimumi 100 kartëmonedha dhe 100 monedha kuna.

KURSI FIKS I KONVERTIMIT
1 EUR = 7,53450 HRK

Nga 1 janari 2024, Banka Kombëtare Kroate do të këmbejë para në kuna për para në euro me një kurs fiks pa pagesë:



KARTMONEDHA KUNA

pa limit kohor

MONEDHA KUNA

(duke përfshirë lipat) tre vjet nga data e vendosjes së Euros, pra deri më 31 dhjetor 2025.

Zëvendësimi automatik

Nëse qytetarët depozitojnë të gjitha kunat në llogaritë e tyre bankare përpara datës 1 janar 2023, ata nuk do të duhet të vijnë në bankë, Fina apo Postën Kroate për të shkëmbyer valutë.

Llogaria e kunës

Nga 1 janari, të gjitha llogaritë kuna kthehen automatikisht llogari në Euro dhe të gjitha bankat janë të detyruara të informojnë me shkrim ose elektronikisht përdoruesit e tyre për detajet e llogarive dhe operacionet personale financiare.

Tabela për këmbim të shpejtë nga kuna në Euro dhe anasjelltas

Nga kuna	në Euro	Nga Euro	në kuna
1 kn =	0,13 €	0,10 € =	0,75 kn
2 kn =	0,27 €	0,20 € =	1,51 kn
3 kn =	0,40 €	0,50 € =	3,77 kn
4 kn =	0,53 €	1 € =	7,53 kn
5 kn =	0,66 €	2 € =	15,07 kn
10 kn =	1,33 €	3 € =	22,60 kn
20 kn =	2,65 €	4 € =	30,14 kn
50 kn =	6,64 €	5 € =	37,67 kn
100 kn =	13,27 €	10 € =	75,35 kn
200 kn =	26,54 €	15 € =	113,02 kn
500 kn =	66,36 €	20 € =	150,69 kn
1000 kn =	132,72 €	50 € =	376,73 kn
2000 kn =	265,45 €	100 € =	753,45 kn
5000 kn =	663,61 €	200 € =	1506,90 kn
10000 kn =	1327,23 €	500 € =	3767,25 kn

SHPALLJA E DYFISHTË E ÇMIMEVE

Afishimi i dyfishtë i çmimeve, në kuna dhe në Euro, zgjat nga 5 shtatori 2022 deri më 31 dhjetor 2023. Çmimet e mallrave dhe shërbimeve duhet të shprehen në mënyrë të qartë, të lexueshme, të dukshme dhe lehtësisht të vëzhgueshme në Euro dhe kuna me kurs fiks dhe sipas rregullave për konvertim dhe rumbullakim në përputhje me Ligjin për vendosjen e Euros.

Nga 5 shtatori, pagat, pensionet, kreditë, depozitat dhe pothuajse të gjitha llogaritë e tjera financiare dhe shërbimet financiare janë të shprehura në kuna dhe në Euro.

Përfashtim nga çmimi i dyfishtë

Përfashtohen nga detyrimi i raportimit të dyfishtë të çmimeve, ata që shesin mallra dhe ofrojnë shërbime në stenda dhe stola, qoftë në tregje me pakicë, jashtë tyre apo brenda qendrave dhe institucioneve tregtare. Përfashtohen ata që bëjnë të njëjtën gjë përmes kioshave, shitjeve në celular, shitjeve të herëpashershme në panaire, ekspozita e të ngjashme.

Kodi etik

Duke qenë pjesë e Kodit të Etikës, kompanitë marrin përsipër të llogarisin dhe shfaqin saktë çmimet dhe jo të rrisin çmimet në mënyrë të pajustificueshme. Qytetarët do të mund t'i njohin Kompanitë që i janë bashkuar Kodit të Etikës me anë të shenjës identifikuese vizuale të shfaqur në pikën e shitjes.



KODI ETIK

Mbrojtja e konsumatorit

Shoqata për Mbrojtjen e Konsumatorëve, në kuadër të projektit "Blerësi sekret për mbrojtjen e konsumatorit në procesin e vendosjes së Euros në Republikën e Kroacisë", do të kontrollojë korrektësinë e konvertimit të çmimeve, dhe Byroja Shtetërore e Statistikave do të monitorojë dhe publikojë çmimin mesatar të mallrave dhe shërbimeve në baza mujore.

Mbikëqyrja e tregtarëve dhe ofruesve të shërbimeve do të bëhet nga 12 institucione shtetërore, mes tyre edhe Inspektoriati Shtetëror.

Qytetarët do të mund të raportojnë parregullsi të mundshme përmes aplikacionit web të Kodit të Etikës.

KREDITË NË KUNA KTHEHEN AUTOMATIKISHT NË EURO



Nga 1 janari 2023, të gjitha kreditë në kuna dhe kreditë me klauzolë valutore në Euro do të kthehen automatikisht dhe pa kosto kredi në Euro.

Kontratat ekzistuese që specifikojnë shumat në kuna do të jenë të vlefshme edhe pas vendosjes së monedhës Euro.

Rregulla për një kontratë ku është rënë dakord për një normë interesi fikse

Në një kontratë, në të cilën është rënë dakord për një normë interesi fikse, kjo normë interesi mbetet e pandryshuar pas datës 1 janar 2023.

Rregulla për një kontratë ku është rënë dakord për një normë interesi të ndryshueshme

Në kontratën ku është rënë dakord për normën e ndryshueshme të interesit, mbetet i njëjtë parametri i rënë dakord përpara vendosjes së monedhës Euro.

Përfundimisht, në një kontratë me një normë interesi të ndryshueshme, në të cilën parametri i rënë dakord për normën e interesit ishte norma kombëtare e referencës (NRS) për kuna, pas vendosjes së Euros do të aplikohet NRS për Euro në vend të NRS për kuna.

NJIHUNI ME KARTËMONEDHAT EURO

**Në qarkullim ndodhen dy seri
kartëmonedhash Euro me vlerë
të barabartë**

Seria e parë përbëhet nga shtatë emetime (5, 10, 20, 50, 100, 200 dhe 500 Euro), dhe tjetra, e cila quhet edhe seria Europa, ka të njëjtat prerje përveç prerjes 500 Euro. Ky emetim nuk shtypet më, por mund të përdoret ende si mjet pagese. Pavarësisht nga seria, çdo emetim i kartëmonedhës Euro dallohet vizualisht nga ngjyra dominuese dhe motivi arkitektonik.

Kartëmonedhat Euro përshkruajnë motive arkitekturore në stile nga periudha të ndryshme të historisë evropiane. Seria e dytë quhet Europa sepse kartëmonedhat shfaqin një portret të Evropës, një personazh nga mitologjia greke.

Seria e pa



Seriali Europa

Monedhat Euro

Seria e monedhave Euro përbëhet nga tetë prerje të ndryshme: 1 cent, 2 cent, 5, 10, 20 dhe 50 cent dhe 1 e 2 €.

Në ndryshim nga kartëmonedhat Euro, monedhat Euro kanë një anë të përbashkët dhe një anë kombëtare, e cila i referohet vendit të emetimit me motive, kështu edhe për Kroacinë. Ana e përbashkët e monedhës përshkruan Bashkimin Evropian ose Evropën dhe simbolizon unitetin e BE-së. Në monedhat 1 dhe 2 cent dhe 5 cent, është paraqitur Evropa në raport me Afrikën dhe Azinë. Monedhat Euro të të gjitha vendeve mund të përdoren në të gjithë Eurozonën.

Simbolet e monedhave kroate Euro të përzgjedhura me pjesëmarrjen e qytetarëve

Shahu kroat është motiv në sfondin e të gjitha monedhave.



Është një hartë gjeografike e Kroacisë në prerjen prej 2 Euro, buza e së cilës është e zbukuruar me vargun "O e bukur, o e dashur, o ëmbla liri" nga Himni për Lirinë e poetit nga Dubrovniku, Ivan Gundulić.



Prerja prej 1 Euro përmban figurën e kunës, e cila është simbol i traditës monetare kroate që nga koha e shekullit të 13-të.



Figura e shpikësit Nikola Tesla gjendet në prerjet prej pesëdhjetë, njëzetë dhe dhjetë cent.



Përcaktimi zyrtar me dy shkronja për Kroacinë, HR, është në monedhat prej pesë, dy dhe një cent, të shkruara me shkrim glagolitik në një formë që kombinon këto dy gërma në një shenjë të vetme tipografike.

NGA DATA 1 DERI 14 JANAR PAGESA NË KUNA DHE EURO



Periudha e qarkullimit të dyfishtë, në të cilën kuna dhe Euro mund të përdoren për pagesa në para, fillon më 1 janar 2023 ora 00:00 dhe përfundon më 14 janar 2023 në mesnatë.

Gjatë periudhës së qarkullimit të dyfishtë, tregtari ose marrësi i pagesës nuk është i detyruar të pranojë më shumë se 50 monedha kuna në një transaksion. Duke vepruar kështu, marrësi i pagesës është i detyruar të zbatojë rregulloret për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të cilat i referohen kufizimit të shumës që mund të paguhet me para në dorë.

Nga 1 dhjetori 2022, konsumatorët do të mund të blejnë maksimumi dy pako fillestare të monedhave Euro në një transaksion në banka, Fina dhe Postën Kroate. Pakoja për konsumatorët përmban 33 monedha euro të të gjitha prerjeve, me vlerë 13.28 Euro, të cilat konsumatori do të mund t'i blejë për 100.00 kuna para në dorë.

Të gjitha informacionet për Euron mund t'i gjeni në faqen e internetit dhe në numrin e telefonit pa pagesë.

www.euro.hr | 0800 20 23

PARATË NË DORË EURO LEHTËSISHT NË BANKOMAT

Bankomatet dhe pajisjet e tjera të vetëshërbimit në operacionet bankare përdorin ekskluzivisht për pagesa para të thata Euro që nga dita e vendosjes së Euros. Rregullimi i ATM-ve do të zgjasë nga dhjetori 2022 deri në mes të janarit 2023 dhe disa ATM nuk do të funksionojnë gjatë kësaj periudhe.

Për të rritur disponueshmërinë e parave të thata, në periudhën kalimtare nga 15 dhjetori 2022 deri më 15 janar 2023, bankat do të përjashtojnë qytetarët nga tarifat kur tërheqin para me kartë debiti në ATM të një bankë të ndryshme nga ajo që ka lëshuar kartën.

